



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 881 Prot.

Tiranë më 8 . 4 .2021

VENDIM

Nr. 6 , datë 30. 032021

*“Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë,  
për vitin akademik 2021-2022”*

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3; neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 e 2; neni 38, pika 1 dhe pika 3; në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, pika 2.7, gërma a, b dhe c, në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 5, gërma “d”, dhe neni 31, gërma “q”; si dhe në propozimet e njëjësive kryesore të UT-së, në mbledhjen e dates 30.03.2021 Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e përgjithshme të pranimit në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2021-2022, në programet e studimeve të ciklit të dytë “**Master i shkencave**”, me kohë të plotë (tabela 2 bashkëlidhur), si më poshtë vijojnë:
  - a. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë brenda vendit: **3223 kuota**
  - b. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga trojet shqiptare: **305 kuota**
  - c. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë shtetas të huaj: **58 kuota**
  - d. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë Romë dhe Ballkanë-egjiptianë): **203 kuota**
  - e. Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **113 kuota**
  - f. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **231 kuota**
2. Të miratojë kuotat e përgjithshme të pranimit në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2021-2022, në programet e studimeve të ciklit të dytë “**Master profesional**”, me kohë të plotë (tabela 3 bashkëlidhur), si më poshtë vijojnë:
  - a. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë brenda vendit: **2131 kuota**
  - b. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga trojet shqiptare: **177 kuota**
  - c. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë shtetas të huaj: **32 kuota**

- d. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (*me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe egjiptianë*):  
**118 kuota**
- e. Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh:  
**52 kuota**
- f. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi:  
**144 kuota**
3. Kuotat e perealizuara të pikave 1/b; 1/c; 1/d; 1/e dhe 1/f; si dhe të pikave 2/b; 2/c; 2/d; 2/e dhe 2/f do të shpërndahen nga Rektorati sipas kërkesave të njësive kryesore të UT-së.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Prof. Dr. Artan Hoxha**

